

Tryezë konsultimi

“Përmirësimi i sigurisë ushqimore nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe dialogut”

“Përmirësimi i sigurisë ushqimore nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe dialogut” – një projekt nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim ([SCiDEV](#)) në partneritet me Shoqatën “Albanian Food Industry” ([AFI](#)). Për këtë projekt SCiDEV ka siguruar mbështetje me një sub-grant nga [Co-PLAN](#), Instituti për Zhvillimin e Habitatit në kuadër të projektit ‘Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri ([ideAL](#))’, financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri në kuadër të Mbështetjes për Shoqërinë Civile – IPA Civil Society Facility and Media Programme 2018 – 2019.

Projekti synon të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë ushqimore në Shqipëri, përmes analizës, vlerësimit të politikave, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ, advokimit dhe ndërgjegjësimit të prodhuesve dhe konsumatorëve. Në këtë kuadër SCiDEV në bashkëpunim me AFI organizoi me 12 prill 2021, një tryezë konsultimi me ekspertë, akademikë, operatorë të biznesit ushqimor, përfaqësues të politikëbërjës dhe të tjerë të interesuar në çështjet e sigurisë ushqimore.

Në këtë takim, pas prezantimit të projektit dhe të të pranishmëve, Blerina Fani, ekspertë ligjore dhe e politikave publike në projekt, ndau me të pranishmit gjetjet paraprake të vlerësimit të kuadrit ligjor dhe politik mbi sigurinë ushqimore në Shqipëri.

Siguria Ushqimore është proces ciklik, i komplikuar, i gjatë dhe po aq i rëndësishëm që prek dhe përçohet nëpërmjet të gjithë ekosistemit tokësor. Si i tillë është mëse e kuptueshme se garantimi i tij është një sipërmarrje e vështirë dhe e ndërlikuar, dhe kjo veçanërisht për atë që kjo siguri nënkupton për shëndetin e njeriut por edhe të gjallesave të tjera. Rëndësia dhe gjithëpërfshirja e trajtimit të kësaj fushe doli në pah edhe gjatë çështjeve që u trajtuan në këtë vlerësim që SCiDEV ka realizuar si hap të parë të projektit. Ekspertja Blerina Fani nënvizoi se legjislacioni i zbatueshëm ka vend të zhvillohet ende edhe më shumë pasi ka një larmishmëri procesesh dhe veprimesh si dhe standarde që duhen përmbushur për të garantuar sigurinë ushqimore. Sikundër me çdo sistem sfida më e madhe është ajo e themelimit dhe e vënies në lëvizje për herë të parë të hallkave ndërlydhëse të tij në mënyrën dhe me kapacitetin e duhur.

Më pas ingranimi në vazhdimësi i sistemit duke u pasuruar gjithmonë e më shumë me informacion mundëson qëndrueshmëri dhe balancë brenda për brenda sistemit dhe një efikasitet në monitorimin e tij. Në këto kushte Shqipëria ballafaqohet ende më fazën e parë të konsolidimit të vënies së në lëvizje të ingranazheve bashkërisht për herë të parë, e cila edhe pse impenjuese duhet të pretojë për zinxhirë të vertetë të prodhimit dhe tregti mit të prodhimit vendas dhe atij të huaj në respekt të plotë të sigurisë ushqimore. Ekspertja shprehet se legjislacioni në tërësi është i mirë organizuar, por ka mangësi në procedurat standarde të veprimit, gjë që e bën ekzekutimin e ligjit të vështirë dhe shpesh të pazbatueshëm.

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është fokusi i ligjit tek prodhuesit dhe procesuesit e mëdhenj, ku ndodh dhe presioni më i madh inspektues dhe monitorues, megjithëse një pjesë e konsiderueshme e prodhimit dhe procesimit të produkteve ushqimore kryhet nga prodhuesit e vegjël dhe familjar. Sipas studimit, kjo lloj dinamike bëhet burim për informalitetin në treg i cili është edhe ndër kontribuesit kryesor të mungesës së sigurisë ushqimore, duke mundësuar shmangien e një pjesë të mirë të mekanizmave dhe proceseve garantues në fakt të parashikuara me ligj. Vetëdeklarimi për përmbushjen e standardeve mbetet një çështje e pa eksploruar mirë, mirërrregullimi i së cilës do të krijonte ndërgjegjësim dhe garanci më të mëdha për sektorin.

Ndërkohë Alban Zusi, Drejtor Ekzekutiv i AFI dhe konsulent në sektorin e biznesit, u ndal në disa rekomandime praktike për përmirësimin e sigurisë ushqimore në vend duke specifikuar veprimet që nevojiten dhe masat që mund të ndërmerren në kuadrin ligjor dhe rregullativ. Këto ndryshime janë paraqitur më poshtë dhe që projekti synon të propozojë:

Propozimi	Masa e Nevojshme
1. Furnizimi me të dhëna nga thertoret – çregjistrimi i bagëtive nga databaza e sistemit RUDA	Urdhër i Ministrit për Thertoret
2. Vendosja e lotit të produkteve ushqimore në faturë	Urdhër i Përbashkët i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve/ Drejtorit të Përgjithshëm të AKU
3. Aprovimi i modelit të çertifikatës shoqëruese të mishit Thertore Dyqan/Restorant	Drejtoria e Sigurisë Ushqimore në Ministri
4. Karte teknologjike e produktit e plotësuar edhe me: <ul style="list-style-type: none"> • mbetjet (modeli i doganës për bizneset fason) • konsumi i energjisë • konsumi i ujit 	Plotësim në Checklistën e AKU
5. Raport i vetëkontrollit të OBU çdo 6 muaj ose 1 herë/vit Modeli i ngjashëm vetëmonitorimi siç kryhet për efektet mjedisore Raporti i vetëkontrollit mund të bëhet nga vetë biznesi për bizneset e vogla ose nga një auditor i çertifikuar për bizneset e mëdha	Të Jetë Pjesë e Checklistës së AKU
6. Çertifikata e konformitetit të lotit të prodhimit	Urdhër i Ministrit të Bujqësisë
7. Përmirësim i administrimit të vulave të thertoreve – mundësisht përdorim i vulave me djegie	Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU
8. Miratimi i udhëzimit për menaxhimin e mbetjeve me origjinë shtazore	Urdhër i Përbashkët i Ministrit të Bujqësisë dhe Ministrit të Mjedisit
9. Çertifikata e eksportit të Lëkurëve të bashkëshoqërohet në arkivën e drejtorisë rajonale të veterinarisë me listën e çertifikatave të gjithë bagëtive që përbëjnë lotin e eksportit	Modeli i Çertifikatës, i Listës Bashkëlidhur dhe Plotësimi në Udhëzim nga Ministria e Bujqësisë
10. Miratimi i çertifikatës që shoqëron nënproduktet (organet e ndryshme nga mishinë dyqane, restorante apo fabrika përpunimi) Rregullorja e re e BE kërkon dhe plan monitorimi	Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë për Modelin e Çertifikatës
11. Modeli i etiketës së tregëtimit të mishit për konsumatorin fundor ku të vendoset: <ul style="list-style-type: none"> • Thertorja 	Përmirësimi i Rregullores së Etiketimit nga Ministria e Bujqësisë

<ul style="list-style-type: none"> • Ferma e Rritjes 	
<p>12. Taksë e AKU mbi prodhimin mbi bazën e e sasisë së deklaruar nga subjekti</p>	<p>Adoptim i Modelit Maqedonas</p>

Të pranishmit gjithashtu sollën shembuj dhe rekomandime konkrete si psh kontrolle më efikase ndaj operatorëve për sigurinë ushqimore e aspekte të tjera të ndërlidhura nga institucionet përgjegjëse; krijimi i urdhrave profesional të munguar (urdhri i teknologut, urdhri i agronimit, urdhri i laborantëve, urdhri i zooteknikëve, etj.) dhe funksionimi i autoriteteve mbikëqyrëse ndaj tyre; funksionimin real të sistemit Ruda dhe integrimin e tij në një databazë të re që duhet të krijohet për rregjistrimin në të gjithë zinxhirin e vlerës nga prodhimi primar deri në treg – i cili gjeneron certifikatat e lëvizjes apo shoqërimit të mallrave; Nevoja për trajnim të prodhuesve të vegjël, fermerëve dhe procesuesve të mishit, si pjesë e rritjes së kapaciteteve që do të mund të rrisë dhe vetëdijen për standardet e sigurisë; futja e certifikatës shoqëruese jo vetëm për karkasën e mishit por edhe nën-produktet e tij (si të brendshmet) dhe gjithashtu trajtimi me kujdes i mbetjeve ushqimore që sot nuk trajtohen dhe në ligj ka vetëm një definicion minimal në një paragraf për këtë. **Rëndësi e veçantë iu kushtua edhe ngritjes së kapaciteteve të fermerëve dhe operatorëve të biznesit ushqimor në përgjithësi, të cilët nuk kanë njohuri për praktikat e mira të punës. Aftësi dhe nevoja për përmirësimin e dijes së aktorëve primar në zinxhirin e prodhimit ushqimor është evidentuar gjithashtu edhe në studimin e kuadrit ligjor të përgatitur në suazë të projektit. Ku ky mosaftësim evidentohet si një ndër burimet që ndikon në moszbatimin e ligjit dhe për rrjedhojë edhe mos garantimit të hapave bazë të sigurisë ushqimore që ai parashikon.**